



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neni 18 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr 06/L-114 , neni 7 të Rregullores nr. 12/2020 për orarin të punës dhe pushimet e zyrtarve publikë si dhe neneve 40 dhe 41 dhe të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunes, nxjerr:

VENDIM
PËR ZGJATJEN E ORARIT TË PUNËS PËR SEKTORIN E GJENDJES CIVILE

Neni 1

1. Me këtë Vendim përcaktohet zgjatja e orarit të punës për Sektorin e gjendjes Civile i cili funksionon në kuadër të Drejtoratit për Administratë në Komunën e Lipjanit.
2. Sektori i gjendjes Civile për periodën prej datës 12.07.2021 e deri me datën 31.08.2021, do të punojë çdo ditë pune me palë nga ora 08:00 deri 16:00 si dhe gjatë ditës së shtunë prej orës 9:00 deri në 15:00.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Administratë.

Arsyetim

Zgjatja e orarit të punës bëhet për shkak të numrit të madh të kërkesave që parashtrohen në këtë Sektor që ndërlidhet me fluksin e ardhjes së mërgimtarëve nga shtetet e ndryshme të botës, të cilët e kanë të nevojshme rregullimin e dokumentacionit.

Nga të cekurat më lart u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
Drejtorit të Drejtoratit për Administratë
Shefit të Sektorit të Gjendjes Civile
Sektorit për Personel

1Nr. 1-130-38151

Lipjan, më 12.07.2021

